

Si mund të përfitoj nënshtetësinë gjermane?

Si rregull, ju mund të aplikoni për marrjen e nënshtetësisë pas 8 (në kushte të veçanta edhe pas 3 ose 6 vitesh) qëndrimi të rregullt në Gjermani.



www.einfachmeinrecht.awo.org



EINFACH
MEIN
RECHT

Është shumë e rëndësishme, që ju të kujdeseni dhe informoheni sa më herët të jetë e mundur, për mundësitë tuaja të qëndrimit.

Sigurohuni që të këshilloheni me dëmtos mbi këtë në një zyrë këshillimi.

E drejta ime për të qëndruar

e shpjeguar thjesht.

www.einfachmeinrecht.awo.org



EINFACH
MEIN
RECHT

Si mund të përfitoj qëndrimin në Gjermani?

Ekzistojnë mundësi të ndryshme për të qëndruar në Gjermani, për shembull për të punuar, për të studiuar, për të mësuar gjermanisht, për të ndjekur shkollën ose për të jetuar bashkërisht me bashkëshortin ose fëmijët tuaj.

Si mund të udhëtoj për në Gjermani?

Nëse ju dëshironi të udhëtoni për në Gjermani, përgjithësisht ju nevojitet një vizë, për të cilën mund të aplikoni në Ambasadën Gjermane në vendin tuaj. Nëse e merrni vizën ose jo, kjo varet nga faktorë të ndryshëm.



Cilat kushte duhet të përmbush?

Kjo varet nga pyetjet, përse ju dëshironi të vini në Gjermani, sa gjatë dëshironi të qëndroni aty dhe nga cili vend vini.

Për shembull, ju duhet të dëshmoni, që keni mjaftueshëm para për të jetuar aty dhe që pas mbarimit të vizës ju do të largoheni sërish.

A mundem të qëndroj edhe pa vizë të vlefshme në Gjermani?

Nëse ju keni hyrë pa vizë të vlefshme në Gjermani dhe dëshironi të qëndroni aty përgjithmonë, ju duhet t'i nënshtroheni sërish procedurës për marrjen e vizës.



Çfarë mundësish të tjera ekzistojnë për të qëndruar në Gjermani?

Ju keni edhe mundësinë të kërkon mbrojtje ndaj përndjekjes ose të qëndroni këtu për arsye humanitare. Kjo do të verifikohet në kuadrin e procedurës për azil.

Nëse kërkesa për azil miratohet, ju merrni një leje qëndrimi.

Nëse kërkesa juaj për azil refuzohet, mund të ndodh, që për një periudhë të caktuar t'ju hiqet e drejta për të hyrë në Zonën Schengen. Për këtë arsye është tepër e rëndësishme, që ju të këshilloheni përpara se të bëni kërkesën për azil.

Si mund të marr një leje qëndrimi?

Për lejen e qëndrimit ju aplikoni pranë Ausländerbehörde (Zyra për të huajt). Të gjithë titujt e qëndrimit jepen fillimisht me afat të kufizuar. Për të zgatur lejen e qëndrimit, ju duhet të dëshmoni herë pas here, që ju i plotësoni kushtet.

Si mund të marr një leje qëndrimi të përhershëm?

Për të marrë një leje qëndrimi të përhershme, normalisht ju duhet të keni leje qëndrimi të rregullt në Gjermani, të punoni dhe të jetoni aty që prej 5 vitesh. Ekzistojnë gjithashtu edhe përjashtime, si për shembull për refugjatët, bashkëshortët dhe studentët.

Nëse ju zotëroni një leje qëndrimi të përhershme në një vend tjetër të BE-së, ju mund të merrni edhe në Gjermani një leje qëndrimi të përhershme.